



## **BURSA NDËRKOMBËTARE NGA PARLAMENTI GJERMAN - BERLIN 2010**

Parlamenti Gjerman në bashkëpunim me **Freie Universität - Berlin, Humboldt-Universität - Berlin, Technische Universität - Berlin** nëpërmjet programit **Internationales Parlaments-Stipendium (IPS)** ju ofron qëndrim pesë mujor në Berlin të Gjermanisë.

Bursat e IPS janë të destinuara për studentë të rinj të kualifikuar dhe të interesuar për shkencat politike – të cilët kanë dëshirë që në mënyrë aktive dhe me përgjegjshmëri të lartë të marrin pjesë në formësimin e ardhmërisë demokratike të vendit të tyre.

Bundestagu Gjerman ju ofron të rinjve mundësinë që brenda periudhës kohore prej 15 javëve, nëpërmjet një anëtari të Bundestagut të njihen me sistemin parlamentar gjerman dhe me procesin e sjelljeve të vendimeve politike. Po ashtu, të përfitojnë edhe përvojë praktike në fushën e punës parlamentare.

Bursistët do të përzgjidhen nga një komision i pavarur i Bundestagut Gjerman.

### **Kushtet:**

- *shtetësia e Maqedonisë*
- *të jenë të diplomuar*
- *zotërim shumë i mirë i gjuhës gjermane*
- *të jenë nën moshën 30 vjeçare*

### **Bursat përfshijnë:**

- *shumë mujore prej 450 eurove*
- *akomodim falas*
- *mbulimin e shpenzime për sigurim dhe transport*

**AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM: 30 QERSHOR 2010**

Për informacione më të detajuara vizitoni: <http://www.bundestag.de/ips> ose drejtohuni në **Ambasadën e Gjermanisë në Shkup**.